



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:108853

Datë: 09.10.2020

Numri i dokumentit: 01177327

PKR.nr.99/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti për Krime të Rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit N. M. nga Gjilani, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda me numër veprues PP.I.nr. 106/2020, të datës 11.09.2020, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Shaban Spahiu, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqwsor dhe publik më datë 01 tetor të vitit.2020, e në prani të palëve, në të njëjtën ditë publikisht shpall, duke përpiluar aktgjykimin më datën 09.10 të vitit 2020,

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri N. M., nga i ati F. dhe e ëma F1 me mbiemër të vajzërisë S, i lindur më datën ... në vranjë, Republika e Sërbis, tani me vendbanim në Gjilan ,posedues i lejes së njoftimit me numër personal ..., posedues i telefonit mobil me SIM karte, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pamartuar, i papunësuar. Me gjendje të dobët ekonomike, i gjykuar për vepra penale të[natyrave të njëjta ndërsa nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, i është tërhequr vëretja se për çdo ndërrim eventual të vendbanimit ose të vendçëndrimit të tij është i detyruar që personalisht apo përmes mbrojtësit të tij ta lajmërojë gjykatën, nën kërcënim të pasojave ligjore.

Ë s h t ë f a j t o r

sepse më datë 17.08 2020, rreth orës 23:50 minuta, në Gjilan , i pamndehuri pa leje dhe pa autorizim në vend publik ka mbajtur në pronësi dhe ka poseduar armën – briskun patent të markës Browning, ngjyrë hiri, me teh rreth 7 cm, të cilin e ka mbajtur në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët,

-me çka ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, neneve: 4, 7, 21, 38, 40, 43, 69, 70, 71 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe neni 72 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 dhe 1.8 të KPRK-s si dhe të dispozitave nga neni 365 lidhur me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (në tekstin e mëtutjeshëm KPP) të pandehurin në fjalë

E GJYKON

me dënim me gjobë në vlerë prej gjashtëqind (600) Euro, të cilën shumë i pandehuri duhet ta paguaj në afat prej tre muajve, duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, përkatësisht pranimi i ftesës për ekzekutimin e këtij dënimi,

mirëpo nëse eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtit dënim me gjobë

I ZËVENDËSOHET me dënim me burgim, në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditëve, të cilin duhet të filloj ta mbaj në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

II. Në kuptim të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së **konfiskohet** arma e ftohtë – brisku patent i markës Browning, ngjyrë hiri ne teg rreth 7 cm, i cili do të shkatërrohet përmes komisionit të formuar nga kryetari i kësaj gjykate.

III. DETYROHET i pandehuri në fjalë që në emër të shpenzimeve të procedurës penale përkatësisht paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) Euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej pesëdhjetë (50) Euro, të gjitha në afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarmit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1) Dispozitat përkatëse lidhur me kompetencën lëndore të kësaj gjykate

Sa i përket kompetencës lëndore të Departamentit për Krime të Rënda të kësaj gjykate kryetari i trupit gjykues ka konstatuar se :

-sipas nenit 19 të Ligjit nr. 06/1-054 për Gjykatat “ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 22/18 Dhjetor 2018, Prishtinë – (i cili sipas nenit 45 të këtij ligji ka hyrë në fuqi më datën 03 janar të vitit 2019) parashihet se:

Departamenti për Krime të Rënda i Gjykatës Themelore i gjykon veprat penale të dënueshme mbi dhjetë (10) vite si dhe veprat penale që konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata me rastin e vendosjes lidhur me kompetencën lëndore përkitazi me veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më 14 prill të vitit 2019, e në anën tjetër sipas aktakuzës lëndore i pandehuri në fjalë dyshohet me bazë se këtë veprë e ka kryer më datën 03.06.2020, **ka ardhur në përfundim** se në zbatim të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/l- 054 për Gjykatat, i cili siç është theksuar më lart ka hyrë në fuqi më datën 03 janar 2019, vepra penale nga neni 366 paragrafi 2 të KPRK-së konsiderohet **krimi rëndë në kuptim të nenit 22 paragrafi 1, nënparagrafi 1.75 të Kodit të Procedurës Penale.**

Siç u cek më lart me dispozitën e nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit në fjalë për Gjykatat si ligj special është **specifikuar kompetenca lëndore e Departamentit për Krime të Rënda të Gjykatave Themelore të vendit tonë, duke u paraparë se “ ... veprat penale konsiderohen krime të rënda sipas Kodit Penal apo Kodit të procedurës penale”**, e me dispozitat të ligjit të mëparshëm kjo kompetencë shprehimisht nuk ka qenë e paraparë. **Mbi këtë bazë edhe është fuqizuar në aspektin ligjor përkitazi me kompetencën lëndore të këtij departamenti dispozita e nenit 22 të Kodit të Procedurës Penale.**

Andaj, pasi që me dispozitën e nenit 19 paragrafi 1. të Ligjit për Gjykatat si ligj special që rregullon kompetencën lëndore të gjykatave në Republikën e Kosovës, e në këtë rast edhe të Departamenteve për Krime të Rënda të Gjykatave Themelore, kryetari i trupit gjykues ka ardhur në përfundim se, nga **data 03 janar 2019** kjo dispozitë **ligjore me fuqi më të lartë juridike e ka delegjitimuar mendimin juridik** të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me numër dhe datë të lartcekur. Kështu që për gjykimin e veprave penale nga **neni 366 të KPRK-së (por edhe nga neni 328 dhe neni 374 të Kodeve të mëparshme**, edhe pse tani sipas nenit 433 të KPRK-së të Kodeve tilla me ndryshime dhe plotësime janë shfuqizuar si akte ligjore, përveç nëse për veprat e tilla – sipas këtyre kodeve gjer më tani nuk është vendosur me aktgjykim të plotfuqishëm) si në rastin konkret **Departamenti i krimeve të rënda i kësaj gjykate ka kompetencë lëndore për vendosje.**

2) Pjesa hyrëse e përgjithshme

Prokuroria Themelore – Departamenti për Krime të Rënda në Gjilan, kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur aktakuzën lëndore, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së, sipas përshkrimit faktik si në aktin akuzues lëndor – por tani edhe në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Kryetari i trupit gjykues pa shtyrje pas pranimit të lëndës penale ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar.

Gjatë seancës së shqyrtimit fillestar i pandehuri është njoftuar me të drejtat e tij në kuptim të nenit 247 të KPP-së duke përfshirë se ka të drejtë të angazhoj mbrojtës profesional. I pandehuri ka deklaruar se i ka kuptuar të drejtat e komunikuar mirëpo nuk dëshironë që të angazhoj mbrojtës profesional, meqë konsideron se është i aftë për t’u mbrojtur gjatë kësaj seance.

Pas leximit të aktit akuzues nga ana e Prokurorit të shtetit, kryetari i trupit gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar përsëritimisht faktik dhe kualifikimin juridik për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet lidhur me pranimin e fajësisë apo deklarimin e tij si i pafajshëm.

I pandehuri ne vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në ngarkesë, e këtë nuk e ka kundërshtuar prokurori i shtetit. Në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP-s pasi që kryetari i trupit gjykues vlerësoi se kërkesat sipas kësaj dispozitenga janë përmbushur nxjerr aktvendim për aprovimin e pranimit të fajësisë për veprën penale lëndore nga ana e të pandehurit në fjalë, duke vazhduar seancën lidhur me rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Prokurori i shtetit ka delaruar se meqë i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila përputhet me deklaratën e dhënë në Prokurori dhe provbat tjera në shkresa të lëndës, gjykatës i ka propozuar që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese siç është rrezikshmëria shoqërore e kësaj vepre penale, pranimi i fajësisë por edhe pendimi për kryerjen e kësaj vepre penale.

Gjithashtu i ka propozuar gjykatës që arma e ftohtë – brisku lëndor patentë i sekuestruar të konfiskohet.

I pandehuri me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë ka deklaruar se e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në ngarkesë, se vërtetë ka gabuar që e ka pasur në posedim briskun patent të markës Browin, se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërit veprime të tilla pasi që ka mbajtur burgun për një vepër tjetër penale dhe se ka gjashtë muaj që i ndihmon dhëndërrit të tij rreth punëve për mom, entin për vendosjen e skeleve, rrethana këto të mjaftueshme për t'i shqiptuar një dënim të arsyeshëm. Për punën e kryer mujore dhëndërrit e paguan 300 Euro dhe se këto para ia jep familjes për nevojat e tyre. Babai i tij punon si mjeshtër për ndërtimin e shtëpive dhe se i njëjti është kryefamiljar i familjes së tij.

4. Pranimi i fajësisë dhe vërtetimi i gjendjes faktike me rrethanat relevante për llojin dhe lartësinë e dënimit

I pandehuri pastaj me vetëdije të plotë dhe vullnet të lirë e ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndore e cila i vihet në barrë me aktin akuzues lëndor duke shtuar se i ka kuptuar benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë pasi që për një gjë të tillë paraprakisht është njoftuar nga kryetari i trupit gjykues.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pas parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të cekura më lartë por rrethana rënduese nuk ka gjetur. Si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh: pranimin e fajësisë, premtimin e sinqert të të pandehurit se nuk do të përsërisë veprime të tilla ose të ngjashme penale, se është penduar seriozisht, se nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, për veprën penale për të cilën është dënuar ka mbajtur tërë dënimin edhe pse organi i ndjekjes penale gjykatës nuk i ka ofruar kurrëfarë prove për këtë, si dhe faktin mjaftë të rëndësishëm për vendosje se i pandehuri është bindur se vetëm me djersën e tij si formë ligjore e fitimit të të ardhurave mund të jetohet meqë me punën e tij siguron të ardhura mujore në shumë prej 300 Euro dhe se këtë shumë ia jep familjes për nevojat e tyre. Rrethana rënduese gjykata nuk ka gjetur.

Pastaj, në bazë të provave të cilat i janë bashkëngjitur aktit akuzues ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në ngarkesë, duke e shpallur fajtor të njëjtion për këtë vepër penale.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar sipas provave të paadministruara por të bashkëngjitura aktit akuzues për shkak se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale lëndore, meqë janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 paragrafi 1 të KPP-s, por edhe rrethanave lehtësuese të cekura më lartë të cilat paraqesin ashtu të sublimuara rrethana veçanërisht lehtësuese në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 lidhur me nenin 72 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 dhe 1.8 të KPRK-s të pandehurit kryetari i trupit gjykues ia caktoj dënimin me gjobë në shumën prej 600 Euro, shumë kjo e zbutur që anon kah minimumi i përgjithshëm i dënimit me gjobë, pasi që sipas nenit 366 paragrafi 1 të KPRK-s si dispozitë e posaçme nuk është caktuar as minimumi i dënimit me gjobë, me bindje se edhe me një dënim të tillë mund të rehabilitohet dhe të parandalohet i pandehuri që mos të kryej vepra penale në të ardhmën, kurse qytetarët potencial mund të disiplinohen në mënyrë që mos të shkelin Kodin Penal, e me këtë do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-s. Me këtë dënim shprehet gjykimi shoqëror i veprimeve inkriminuese të të pandehurit e të cilat paraqesin figurën e veprës penale lëndore, me qëllim të ngritjes së moralit dhe forcimit të detyrimit për të respektuar Kodin Penal me të cilat mbrohen të mirat vitale juridike, e në rastin konkret siguria e qytetarëve meqë posedimi i armëve pa autorizim të njëjtat i shndërron në mjete mjaftë të rrezikshme për jetën dhe trupin e qytetarëve të vendit.

Po ashtu i pandehuri në fjalë është njoftuar edhe për mundësinë e zëvendësimit të dënimit me gjobë me dënim me burgim në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, në rast se i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj pjesërisht ose në tërësi dënimin me gjobë, edhe atë se për çdo njëzet (20) Euro gjobë do t'i llogaritet nga një (1) ditë burgim. Me qëllim që mos të vendoset me aktvendim të posaçëm gjatë procedurës së ekzekutimit lidhur me këtë lëndë penale, në rast se eventualisht i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj dënimin me gjobë, gjykata në dispozitiv të këtij aktgjykimi ka zëvendësuar dënimin me gjobë me atë me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-s me mundësi të ekzekutimit vetëm për arsyet e lartcekura.

Gjykata pas shpalljes së aktgjykimit në kuptim të nenit 368 të KPP-së palët gjithashtu i ka udhëzuar për të drejtën në ankesë, ndërsa asnjëra prej tyre shprehimisht nuk është deklaruar se dëshiron të paralajmërojë ankesë apo të heqë dorë nga e drejta në ankesë.

5) Konfiskimi i sendeve të sekuestruara, shpenzimet e procedurës penale – paushallit gjyqësor si dhe taksën për kompenzimin e viktimave të krimit

Gjykata po ashtu në bazë të nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së si dhe nenit 282 paragrafi 1 të KPP-së ka vendosur që detyrimisht të konfiskohet arma lëndore e ftohtë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 450 dhe 453 të KPP-së, gjykata e ka detyruar të pandehurin që lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej pesëdhjetë (50) euro.

Në kuptim të nenit 39 të Ligjit nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, përkitazi me shumën e taksës për kompensimin e viktimave, gjykata vendosi që ta detyrojë të pandehurin të paguajnë shumën prej pesëdhjetë (50) euro.

Për arsyet e lartcekura, në kuptim të nenit 248 dhe 365 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr.99/2020, më datë 01 tetor të vitit 2020.**

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj Gjykate.